



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Organit Shqyrtues të Prokurimit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të OSHP kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryesuesi i Sekretariatit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryesuesi i Sekretariatit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Organit Shqyrtues të Prokurimit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Organit Shqyrtues të Prokurimit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Organit Shqyrtues të Prokurimit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që

cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë procesit të auditimit, kemi identifikuar disa fusha ku mund të përmirësohet performanca duke përfshirë kontrollin e brendshëm. Testet tona kanë treguar që nevojiten përmirësime në respektimin e rregullave financiare në procesimin e pagesave, pagesën e faturave, menaxhimin e pasurisë dhe hartimin e rregullës së brendshme për caktimin dhe përzgjedhjen e ekspertëve të jashtëm në shqyrtimin e ankesave dhe plotësimin e anëtarëve të bordit.

Raporti i auditimit ka rezultuar me tre (3) rekomandime të reja dhe një (1) rekomandim pjesërisht të përsëritur. Ne do të përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishte 156,355€, prej tyre ishin shpenzuar 141,794€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime këshillëse, furnizim me kompjutera, furnizim me materiale zyrtare, furnizim me ujë për pije, qiraja për vetura, sigurimi fizik i objektit, udhëtime zyrtare, telefoni mobile, fotokopje me qira, furnizim me derivate, dreka zyrtare e të tjera.

Çështja A1 - Zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjës pas pranimit të faturës

- Gjetja** Rregulla financiare Nr.01/2013, në nenin 15, përcakton që procedurat e blerjes duhet të fillojnë me një kërkesë për blerje, pastaj zotimi i mjeteve, pas të cilës duhet të procedohet me urdhër blerje, pranimin e mallit ose shërbimit, shpenzimi dhe më në fund pagesën e faturës.
- Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se në gjashtë (6) raste në vlerë totale 3,870€, zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet ishin proceduar pas pranimit të faturës.
- Kjo ka ndodhur për shkak të volumit të madh të punëve që ka secili zyrtarë në Organizatën Buxhetore dhe moszbatimit të procedurave për shpenzimet e parasë.
- Ndikimi** Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave mund të shkaktojë ndikim të mos kryerjes së obligimeve të faturuara në kohë, duke çuar në rritjen e detyrimeve të papaguara, që në fund do të shkaktojnë probleme për buxhetin e vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi A1** Kryetari i OSHP-së duhet të sigurohet që, zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjeve bëhet para se të pranohen mallrat dhe faturat, në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohet rritja e detyrimeve të pa paguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Vonesë në pagesën e faturave

- Gjetja** Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve duhet të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës, siç është përcaktuar në nenin 39.1 të Ligjit nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Identifikuam se në tre (3) raste, faturat në vlerë totale prej 1,849€ të paraqitura në pasqyra, përfaqësojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesë që varion nga 20 ditë deri në 29 ditë.

Pagesat jo me kohë të detyrimeve kanë qenë për shkak të volumit të madh të punëve që ka secili zyrtarë në Organizatën Buxhetore dhe ndrimi i llogarisë së furnitorit të regjistruar në Thesarë.

Ndikimi Si pasojë e kësaj vonesë në pagesat, Organizata Buxhetore mund të përballet me kosto shtesë të interesave dhe gjobave për vonesat e kërkuara nga palët e treta.

Rekomandimi A2 Kryetari i OSHP-së duhet të forcojë kontrollet në fushën e financave për të siguruar se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimi të faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mungesa e metodologjisë për përzgjedhjen e ekspertëve të jashtëm

Gjetja Ligji Nr. 04/L-042 – Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 107 - Rregullorja e procedurave të OSHP-së “OSHP do të vendosë rregulloren e punës për të udhëhequr ushtrimin e procedurave të shqyrtimit”.

Gjatë testimit të pagesave, kemi vërejtur se OSHP angazhon ekspert të jashtëm për shqyrtimin e ankesave, megjithatë, menaxhmenti nuk ofron asnjë procedurë të brendshme ose metodologji të dokumentuar që përcakton procesin për përzgjedhjen dhe caktimin e ekspertit të vlerësimit për shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomik pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Vlenë të theksohet se OSHP për menaxhimin e lëndëve, përdor systemin e automatizuar, SML (Sistemi për Menaxhimin e Lëndëve), ku përfshin, pranimin e ankesës, autorizimi i ekspertit nëpërmjet një sistemi rotacioni elektronik, dorëzimi i raportit të ekspertizës, hartimi i vendimit dhe marrja e vendimit final nga Paneli Shqyrtues.

Mungesa e një metodologjie të dokumentuar përcakton se menaxhmenti nuk ka vendosur kontrole të brendshme për të siguruar funksionimin sa më efikas dhe efektiv të procesit të shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomik.

Ndikimi Mungesa e procedurave të qarta për përzgjedhjen dhe caktimin e ekspertëve të jashtëm, mund të ndikoj në mungesën e transparencës gjatë përzgjedhjes së tyre dhe në performancën e realizimit të këtyre shërbimeve.

Rekomandimi A3 Kryetari i OSHP-së duhet të sigurohet që sa më shpejt të nxirren procedura të brendshme të qarta që përcaktojnë metodologjinë dhe procedurën për përzgjedhjen dhe caktimin e ekspertëve të jashtëm për shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 0€, pasurive jokapitale është 24,091€, si dhe e stoqeve 18,681€.

Çështja C1 - Mosregjistrimi e pasurive dhe paraqitjen jo të plotë në shpalosjet e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF)

Gjetja Duke u bazuar në Rregulloren Nr. 02/2013 "Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore", neni 6, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financiar të Kosovës (SIMFK), ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria".

Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se një shumë prej 1,044€ pagesa për tavolinë për takime për 8 persona nuk ishte regjistruar në regjistrin kontabël të SIMFK-së. Gjithashtu vërejtëm se një shumë tjetër prej 99.90€ radiator elektrik 12 brinjë 3000W nuk ishte regjistruar në regjistrin e-pasuria.

Shkaku i mosregjistrimit të pasurive ishte mungesa e komunikimit të ndërsjellë në mes të zyrtarëve përgjegjës në organizatë.

Ndikimi Mungesa e regjistrimeve të saktë dhe të plotë ka shkaktuar mungesë të informatave për menaxhmentin duke shkaktuar nën-vlerësim të pasurive, si dhe ndikon në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi C1 Kryetari i OSHP-së të sigurojë se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurive, si dhe prezantimi i tyre në PVF të jetë i plotë dhe i saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezentuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	419,631	383,534	364,940	283,443	295,577
Grante Qeveritare – Buxheti	419,631	383,534	364,940	283,443	295,577

Buxheti final është më i ulët në raport me buxhetin fillestar për 36,097€. Ky zvoglim është rezultat i Vendimit të Qeverisë në vitin 2023, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka shpenzuar rreth 95% të buxhetit final ose 364,940€, me një rritje afër 29% krahasuar me shpenzimet e vitit 2022.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	419,631	383,534	364,940	283,443	295,577
Pagat dhe mëditjet	258,176	222,079	222,079	190,806	180,527
Mallrat dhe shërbimet	156,355	156,355	141,794	91,899	113,911
Komunalitë	5,100	5,100	1,067	738	1,138


Shpjegimet për ndryshimet në kategorinë e buxhetit janë dhënë si më poshtë:

-Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 222,079€ dhe është më i ulët se ai fillestar për 36,097€. Shpenzimet në këtë kategori ishin i njëjtë me buxhetin final.

-Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte i njëjtë me atë fillestar, në vlerë 156,355€, nga të cilat afër 91% janë shpenzuar gjatë vitit.

-Buxheti final për shpenzime komunale ishte i njëjtë me atë fillestar, në vlerë: 5,100€ ndërsa shpenzimi është afër 21% e buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga OSHP për vitin 2023 ishin në vlerë 432,042€.

Të hyrat në vlerë 422,042€ janë realizuar nga konfiskimet e depozitave si rezultat i vendimeve të Paneleve Shqyrtuese për konfiskim dhe 10,000€ e hyrë nga gjoba për Komunën e Parteshit.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	72,982	72,982	432,042	125,712	18,296
Të hyrat jo tatimore	72,982	72,982	432,042	125,712	18,296

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i Auditimit për PFV-të e vitit 2022 të OSHP ka rezultuar me një rekomandim. OSHP kishte paraqitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do ta zbatoj rekomandimin e dhënë. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, ky rekomandim ishte zbatuar pjesërisht.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasuritë	Kryetari i OSHP duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë janë regjistruar në sistem dhe janë aplikuar normat e zhvlerësimit, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	Janë ndërmarrë veprime si zhvlerësimi i pasurisë, ekziston regjistëri i pasurive nën 1,000 euro dhe stoqeve.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Agim Sheqiri

Ud. i Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së

Data: 06.06.2024

Nënshkrimi:

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.